



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 11680 Prot.

Tiranë, më 9/05/2019

**UDHËZIM**

Nr. 09 datë 09/5/2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 2 DT. 27.09.2012  
“MBI PËRCAKTIMIN E MASËS SË GARANCISË PËR MAGAZINAT FISKALE TË  
PRODHIMIT/PËRPUNIMIT, STOKIMIT DHE NË LËVIZJEN E MALLRAVE TË  
AKCIZËS NËN PEZULLIM”**

Në zbatim të neneve 21 deri 29 dhe 108, të ligjit nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe neneve 72 deri 76, të VKM 612 datë 05.09.2012 “Për dispozitat zbatuese të ligjit Për Akcizat”, të ndryshuar;

Me qëllim qartësimin, standardizimin dhe zbatimin me korrektësi të legjislacionit të akcizës dhe përmirësimin e akteve të treta në zbatim të qëndrueshmërisë së këtij kuadri ligjor lidhur me aplikimin e masës së garancisë globale;

**UDHËZ O J:**

Në udhëzimin nr. 2, dt. 27.09.2012 “Mbi përcaktimin e masës së garancisë për magazinat fiskale të prodhimit/përpunimit, stokimit dhe në lëvizjen e mallrave të akcizës nën pezullim”, bëhet ndryshimi, si më poshtë:

1. Pika 5, ndryshon si vijon:

“Masa e garancisë për produktet energjitike përcaktohet sipas nenit 22, pika 5, të ligjit 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe neneve 73 dhe 75, pika 1 gërma (c) të VKM nr. 612, dt. 05.09.2019, “Për Dispozitat Zbatuese të ligjit për Akcizat”, të ndryshuar.”

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Arlind Gjokuta**

